



Në pajtim me nenin 4 paragrafin 2 pikën 1 të Vendimit për organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, 22/23), Sekretariati për Vetëqeverisje Lokale i Komunës së Tuzit shpall

**THIRRJE PUBLIKE PËR ORGANIZATAT JOQEVERITARE  
PËR PROPOZIMIN PERFAQESUESËVE PER PJESEMARRJE NE GRUPIN PUNUES  
PER KRIJIMIN E PLANIT LOKALE AKCIONAL TË VEPRIMIT PËR TË RINJËT  
PËR VITIN 2024**

Me qëllim të krijimit të Planit Lokal akcional për të rinjtë për vitin 2024, është parashikuar me Strategjinë nacionale për të Rinjtë për periudhën 2023-2027 dhe Planin e akcional 2023-2024., Sekretariati për Vetëqeverisje Lokale shpall thirrje publike për të gjitha organizatat joqeveritare të interesuara në territorin e Komunës së Tuzit Për propozimin e përfaqësueseve për pjesëmarrje në grupin punues me rastin e hartimit të Planit akcional për të rinjtë për vitin 2024.

Në bazë të qëllimeve operative nga Strategjia nacionale për të rinjtë, e miratuar në seancën e Qeverisë më 19 tetor 2023, me Planin lokal akcional definohe aktivitetet të cilat mund të realizohen në bashkëpunim me organizatat joqeveritare.

Strategjia parasheh katër qëllimet e mëposhtme operative dhe organizatat joqeveritare ftohen të delegojnë përfaqësuesit e tyre për të krijuar aktivitete në fushat e mëposhtme:

- Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm shërbimesh për të mbështetur të rinjtë në procesin e tranzicionit të tyre drejt moshës madhore - Aktivitete në fushën e përmirësimit të punës së të rinjve, edukimit joformal, promovimit të programeve të lëvizshmërisë për të rinjtë;
- Krijimi i kushteve që të rinjtë të jenë qytetarë aktivë, të përfshirë në krijimin dhe zbatimin e politikave publike – Aktivitete në fushën e avancimit të mekanizmave për përkrahjen e iniciativave të të rinjve, pjesëmarrje në sjelljen e vendimeve dhe zhvillimin e bashkësisë.
- Avancimi i pozitës së të rinjve, përmes qasjes mes departamenteve;
- Avancimi i kuadrit normativo-institucional për zbatimin e politikës rinore.

Afati për dorëzimin e paraqitjeve për pjesëmarrje në grupin punues për hartimin e Planit lokal akcional është **7 ditë, (me përfundim më datën 08 tetor)** nga dita e publikimit të thirrjes publike.

Organizata joqeveritare është e obliguar që paraqitjen ta dorëzoi në formularin e paraparë i cili është pjesë përbërëse e thirrjes publike.

Aplikimet me biografi duhet të dorëzohen me shkrim, në zarf të mbyllur me shënimin: Sekretariati për Vetëqeverisjen Lokale, aplikimi në: “Thirrje publike për propozimin e përfaqësuesit për pjesëmarrje në grupin punues gjatë hartimit të Planit lokal akcional për të rinjtë për vitin 2024. ”, në arkivin e Komunës së Tuzit ose me postë në adresën: Rruga : Tuzi rruga 1, numër 44, 81206, Tuzi. Telefoni kontaktues: +38220875167;

Është e nevojshme që organizata joqeveritare që propozon përfaqësuesin e saj në grupin punues të regjistrohet në regjistrin e organizatave joqeveritare para publikimit të thirrjes publike dhe selia e saj të jetë në territorin e Komunës së Tuzit.

Në bazë të aplikacioneve të dorëzuara, Sekretariati për Vetëqeverisje Lokale, si organ i vetëqeverisjes lokale i ngarkuar për krijimin dhe zbatimin e politikave rinore, do të përpilojë listën e përfaqësuesve të organizatave joqeveritare për pjesëmarrje në grupin punues.

Me propozim të Sekretariatit për Vetëqeverisje Lokale, Kryetari i Komunës do të nxjerrë Vendim për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Lokal Akcional për të rinjtë.



**SEKRETARE,**  
**Marina Ujkaj**